

# **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "TOSKA"**

Në bazë të ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismes së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" si dhe të ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 12.03.2007, Themeluesit:

1. **BEHAR SAFET TOSKA**, lindur në fshatin Morave Komuna Otlak Berat me 21.01.1973, banues në fshatin Morave Komuna Otlak Berat, me çertifikate numër 5-83 date 18.02.2007.
2. **Afrim Estref Dosti**, lindur në fshatin Bregas Komuna Vertop Berat me 19.03.2007, banues në Bregas Komuna Vertop Berat, me çertifikate numër 1-88 date 31.03.2007.

Deklarojnë se kanë vendosur të nënshkruajnë këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

## **Neni 1-Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është "**TOSKA**".

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet "SH.P.K" dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

## **Neni 2-Vëndndodhja e selisë**

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në fshatin Morave Komuna Otlak Berat, Shqipëri.

## **Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **Neni 4- Objekti i veprimtarisë**

Objekti i shoqërisë është si më poshtë:

- Shërbime në fushën e ndërtimit si ndërtime e rikonstruksione objekte social kulturore, banesa etj.
- Tregti me shumicë e pakicë import-eksport mallra industrial e bujqësor.



- Produhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit. Shfrytëzimi i mineraleve të grupit të katërt sipas ligjit mineral shqipëtar si gur, gëlqere, argjil etj, si dhe kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.
- Prodhim, përpunim dhe tregtimi i produkteve me karakter industrial e bujqësor import-eksport.
  - Transport kombëtar e ndërkombëtar i mallrave dhe udhëtareve për vete e të tretë.

### **Neni 5- Kapitali Themeltar**

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 600.000 (Gjashtëqindmije) leke.
- 2) Kapitali themeltar është i përbërë nga 600 (Gjashtëqind) pjesë kapitali me vlerë nominale 1000 (njëmijë) leke secila, të gjitha të nënshkruara e të paguara.

### **Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**

1. Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtme:
  - Z. Behar Toska ka kontribuar në para në shumën në shumën 300.000 (treqindmije) lekë.
  - Z. Afrim Dosti ka kontribuar në para në shumën në shumën 300.000 (treqindmije) lekë.
2. Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:
  - Z. Behar Toska i takojnë 300 (treqind) pjesë kapitali ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - Z. Afrim Dosti i takojnë 300 (treqind) pjesë kapitali ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit**

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

### **Neni 8- Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
3. Administratori i parë i shoqërisë është Z. Behar Toska.
4. Z. Behar Toska është pajisur me mandat për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Rregjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të regjistrohet në regjistrin tregtar.

#### Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### Neni 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### Neni 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Berat, më 29.05.2007.*

## ORTAKËT

BEHAR TOSKA

*Behar Toska*

*BT*

AFRIM DOSTI

*Afrim Dosti*

*AD*

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"TOSKA"**

**KAPITULLI I**  
**EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1- Forma**

1. Midis personave pronarë të pjesëve të kapitalit themeltar siç tregohet më poshtë dhe atyre që mund të bëhen më pas pronarë të pjesëve të kapitalit themeltar është krijuar një shoqëri në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar që rregullohet nga ligjet në fuqi dhe nga ky statut.
2. Statuti është në përputhje me ligjet dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në të rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 2- Emërtimi**

1. Emërtimi i shoqërisë është "TOSKA".
2. Në të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emërtimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet "SH.P.K" dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

**Neni 3-Objekti**

1. Objekti i shoqërisë është si më poshtë:
  - ♦ Shërbime në fushën e ndërtimit si ndërtime e rikonstruksione objekte social kulturore, banesa etj.
  - ♦ Tregti me shumicë e pakicë import-eksport mallra industrial e bujqësor.
  - ♦ Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit. Shfrytëzimi i mineraleve të grupit të katërt sipas ligjit mineral shqipëtar si gur, gëlqere, argjil etj, si dhe kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.
  - ♦ Prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i produkteve me karakter industrial e bujqësor import- eksport.
  - ♦ Transport kombëtar e ndërkombëtar i mallrave dhe udhëtareve per vete e të tretë.

**Neni 4- Vëndndodhja e selisë**

1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet, në fshatin Morave Komuna Otllak Berat, Shqipëri.

- 
2. Transferimi i selisë së shoqërisë në një vënd tjetër mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

#### **Neni 5-Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jete pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Shoqëria mund të shpërndalet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.

#### **Neni 6- Përgjegjësia**

1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qellime që nuk përputhen me ato të percaktuara nga statuti dhe akti i themelimit.
2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave fizike, juridike, privat ose publik, brënda ose jashtë shtetit.

### **KAPITULLI II** **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT** **THEMELTAR**

#### **Neni 7- Kapitali Themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 600.000(Gjashtëqindmije) lekë.
2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 600 (Gjashtëqind) pjesë kapitali, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara.

#### **Neni 8-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**

1. Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masen dhe menyren e mëposhtëme:
  - Z. Behar Toska ka kontribuar në para në shumën 300.000 (treqindmije)lekë.
  - Z. Afrim Dosti ka kontribuar në para në shumën në shumën 300.000 (treqindmije)lekë.
2. Këto pjesë janë nënshkruar dhe shlyer tërësisht si më poshtë:
  - Shuma e derdhur nga ortaku Behar Toska për 300.000 leke është depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në Raifeissen Bank sh.a Dega

Bërat dhe derdhja e saj është evidentuar në çertifikatën e depozitimit e leshuar nga Raiffeissen Bank sh.a Dega Berat.

- Shuma e derdhur nga ortaku Afrim Dosti per 300.000 leke është depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në Raiffeissen Bank sh.a Dega Berat dhe derdhja e saj është evidentuar në çertifikatën e depozitimit e leshuar nga Raiffeissen Bank sh.a Dega Berat.

3. Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

- **Z. Behar Toska i takojnë 300 (treqind) pjesë kapitali ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**
- **Z. Afrim Dosti i takojnë 300 (treqind) pjesë kapitali ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

#### **Neni 9- Zmadhimi i Kapitalit Themeltar.**


1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të reja vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar sipas modaliteteve të parashikuara në nenet 62 dhe 63 të ligjit nr.7638 "Për shoqëritë tregtare".
2. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të reja, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjeset e kapitalit të zotëruar. Në rast se ata nuk e ushtrojnë këtë të drejte, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjere proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive dhe në rast mungese të nënshkrimit, mund të nënshkruen nga të tretët me miratim të ortakëve në të njëjtat kushte si transferimi i pjesëve një te treti.

#### **Neni 10- Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

1. Kapitali themeltar mund të zvogëlohet vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar sipas modaliteteve të parashikuara në nenin 64 të ligjit nr.7638 "Për shoqëritë tregtare".
2. Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që zotërojnë.
3. Kapitali themeltar, për çfardo shkak qoftë, nuk mund të zvogëlohet në një shumë më të vogël se minimumi ligjor. Në rastin e moszbatimit të kësaj dispozite çdo i interesuar mund të kërkojë nga gjykata kopetente prishjen e shoqërisë.

#### **Neni 11- Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

1. Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen të tretëve ose ortakëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

- 
2. Ortaku që kërkon të transferojë pjesët e tij duhet të njoftojë për projektin e tij si administratorin ashtu edhe secilin ortak. Njoftimi duhet të bëhet me letër rekomande me kthim përgjigje për marrjen e njoftimit.

Mbledhja e asamblesë për miratimin ose refuzimin e projektit të transferimit duhet të bëhet brenda 3 muajëve nga data e njoftimit.

Vendimi i ortakëve i njoftohet transferuesit me letër rekomande me kërkesë për marrje lajmërim për marrjen e vendimit.

Në rast se shoqëria nuk ka vendosur brenda tre muajëve, nga data e njoftimit të fundit miratimi konsiderohet i dhënë.

Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, ortakët duhet të blejnë ose të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vleresimin e të drejtave me ekspert vleresues të caktuar nga palët ose kur ata nuk merren vesh ndërmjet tyre, me ekspert të caktuar nga gjykata.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me treshegimi ose brenda familjes bëhet me miratim të ortakëve me kushte jo me pak të favorshme se ato të percaktuara për të treta.

### **KAPITULLI III** **ASAMBLEJA, ADMINISTRIMI, KONTROLLI**

#### **Neni 12- Asambleja e ortakëve dhe kompetencat**

1. Organi vendimmarres i Shoqërise është Asambleja e Ortakëve. Sipas natyrës së vendimeve që ato thirren për të marrë Asambletë e Ortakëve cilësohen Asamble të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme.
2. Vendimet që merr ky organ me shumice votash janë të detyrueshme për ortakët që mungojnë ose që kanë mendim të kundërt. Ortakët kanë të drejtën e ankimit të cilën mund ta ushtrojnë në rastet, kohën dhe format që parashikohen nga ligji.

#### **Neni 13-E drejta e pjesëmarrjes dhe e votimit.**

1. Çdo ortak, pavarësisht nga numri i pjesëve që zotëron, ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe të marrë pjesë në vendimet e saj. Ai disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.
2. Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër.
3. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër i paisur me një mandat të posaçëm në kushtet e parashikura nga ligji, me anë të së cilit mund të japë votën e tij.
4. Një ortakë nuk mund të ngarkojë një mandatmbajtës të votojë në emër të një pjesë të kapitalit të tij themeltar, duke votuar ai vetë në emër të pjesës tjetër të kapitalit të tij themeltar.



## **Artikulli 14- Thirrja dhe vendimet e Asamblesë.**

1. **Vendimet merren nga Asambleja.**
2. Asambleja mund të thirret në çfardollos momentin nga administratori. Ajo mund të thirret gjithashtu, nga eksperti/ët kontabël i autorizuar në rast urgjence, nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar, nga një mandat mbajtës i caktuar nga gjykata dhe kur është rasti nga likuidatori/ët.
3. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet një letre rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve, në adresat që janë shkruar në librin e ortakëve, dhe ekspertit/ve kontabël të autorizuar të paktën 15 (pesëmbëdhjet) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Në këtë letër njoftohet rendi i ditës, vëndi, data dhe ora e mbledhjes.
4. Asambleja do të mbahet rregullisht edhe pa respektuar këto formalitete, nëse marrin pjesë apo janë të përfaqësuar të gjithë ortakët, administratori dhe eksperti kontabël i autorizuar.
5. Asambleja e Zakonshme thirret të paktën një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajesh nga mbyllja e vitit për miratimin e llogarive vjetore, inventarëve dhe të raporteve të administratorëve e të ekspertit/ve kontabël të autorizuar në se ka të tillë.
6. Asambleja e Zakonshme vendos mbi të gjitha çështjet që nuk janë në kompetencën e Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe në veçanti vendos:
  - Të miratojë strategjinë e zhvillimit afatë gjatë të shoqërisë.
  - Të miratojë plan- biznesin dhe planin financiar vjetor.
  - Të miratojë, ndryshojë ose të hedhë poshtë llogaritë vjetore që i janë shtruar për miratim.
  - Të vendosë për shpërndarjen dhe destinimin e rezultatit në pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
  - Të emërojë ose të zëvendësojë administratorin.
  - Të caktojë menyrën dhe masen e shperblimit të administrimit.
  - Të emërojë ekspertin/et kontabël të autorizuar.
  - Të miratojë marrëveshjet midis shoqërisë dhe një prej administratoreve ose ortakëve të saj.

Në mbledhjet e Asamblesë vendimet merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Nëse mungon numri i nevojshëm i pjesëmarrësve, Asambleja duhet të thirret për herë të dytë dhe në këtë rast mund të zhvillohet e të vendosë me shumicën e votave të dhëna pavarësisht nga numri i ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ata përfaqësojnë.

7. Asambleja e jashtëzakonshme vendos:

- Mbi ndryshimet e Statutit;
- Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar;



- Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera;
- Mbi transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar;
- Mbi emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve;
- Mbi transformimin e shoqërise në nje formë tjetër.

Asambleja e Jashtëzakonshme është e vlefshme dhe mund të marrë vendime në thirrjen e parë dhe të dytë, me prezencën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar dhe me voten pro të ortakëve të cilët përfaqësojnë, si në thirrjen e parë ashtu edhe të dytën, të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

8. Asambleja drejtohet nga administratori. Në rastin kur administratori nuk është ortak mbledhja drejtohet nga ortaku që zotëron numrin më të madh të pjesëve, dhe që pranon të drejtojë mbledhjen. Kur numri i pjesëve është i barabartë drejtimi i mbledhjes bëhet nga ortaku më i moshuar.
9. Vendimet e Asamblesë duhet të evidencohen në një procesverbal, i cili firmoset nga drejtuesi i seancës dhe nga administratori. Kur asnjë nga administratorët nuk është ortak, një nga ortakët duhet të caktohet për të firmosur. Në procesverbal duhet të përfshihen shënime që vijojnë:
  - Datën dhe vëndin e mbledhjes.
  - Emrin, mbiemrin dhe cilësinë e drejtuesit të mbledhjes.
  - Emrin, mbiemrin e ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar me tregimin e numrit të pjesëve të kapitalit themeltar të zotëruar nga secili.
  - Dokumentat dhe raportet e paraqitura në asamble.
  - Tekstet e projektvendimeve të vëna në votim si të atyre të miratuara ashtu dhe të atyre që janë hedhur poshtë.
  - Rezultatet e votimeve.

### **Neni 15- Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
3. **Administratori i parë i shoqërisë është Z. Behar Toska** i cili pranon funksionin dhe pohon se nuk është prekur nga asnjë papajtueshmëri apo ndalim që pengon emërimin e tij.



**Neni 16- Marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një prej administratorëve ose ortakëve të saj.**

1. Administratori ose Eksperti Kontabël i Autorizuar, po qe se ka të tillë, përgatit raport për marrëveshjet e arritura, direkt apo nëpërmjet një personi ndërmjetës, midis shoqërisë dhe një prej administratorëve ose ortakëve të saj. Ky raport paraqitet në Asamble ose i bashkangjitet dokumentave që u paraqiten ortakëve të saj. Asambleja vendos rreth këtij raporti. Administratori ose ortaku i interesuar nuk mund të marrë pjesë në votim dhe pjesët e tij të kapitalit themeltar nuk merren parasysh në llogaritjen e quorumit dhe te shumices.
2. Pasojat e marrëveshjeve ta pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Dispozitat e këtij neni shtrihen edhe për marrëveshjet e kryera me një shoqëri, në të cilën një ortak "i pa kufizuar", administrator anëtar i drejtorise apo i keshillit mbikqyrës është njëkohësisht administrator apo ortak i shoqërisë.
4. Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për marrëveshjet që kanë të bëjnë me operacionet rrjedhëse dhe të kryera në kushte normale.

**Neni 17- Marrëveshjet e ndaluara.**

1. Administratorëve ose ortakëve që nuk janë persona juridike nuk u lejohe të kontraktojnë në çfardolj forme qoftë, të marrin hua nga shoqëria, t'u akordohet nga shoqëria një zbulim në llogari rrjedhëse ose në një forëm tjetër, si dhe të bëjnë shoqërinë dorëzënëse apo garante për detyrimet e tyre ndaj të tretëve. I njëjti ndalim zbatohet ndaj bashkëshortëve, paraardhesve dhe pasaardhesve të personave të përmëndur në këtë nen si dhe për çdo person ndërmjetës.

**Neni 18- Ekspertet Kontabël të Autorizuar.**

1. Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa ekspert kontabël të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Në caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmëritë e përcaktuara nga ligji nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
2. Eksperti/et kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Zakonshme, për një periudhë prej 6 (gjashtë) vitesh financiare, me të drejtë rizgjedhje nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 50% (pesedhjet përqind) të kapitalit themeltar.
3. Detyrat dhe të drejtat e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare". Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.



**KAPITULLI IV**  
**VITI FINANCIAR, INVENTARI, LLOGARITË VJETORE**  
**SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 19- Viti financiar.**

1. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
2. Përfundimisht viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.

**Neni 20- Inventari, llogaritë vjetore.**

1. Shoqëria mban një kontabilitet të rregullt në pajtim me ligjin.
2. Në mbyllje të çdo ushtrimi financiar Administratori harton inventarin e elementëve të ndryshëm të aktivitetit dhe të pasivitetit në këtë datë, si dhe llogaritë vjetore të shoqërisë.
3. Administratori harton raportin vjetor për gjëndjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar të mbyllur, ndryshimet e ardhëshme të parashikueshme, ngjarjet e ndodhura midis datës kur është hartuar raporti, dhe veprimet e kërkimit dhe të zhvillimit.
4. Llogaritë vjetore, inventari, raporti i Administratorit, teksti i vendimeve të propozuara dhe në qoftë se është nevoja raporti i Ekspertit/ve Kontabël të Autorizuar, u komunikohen ortakëve dhe vihen në dispozicion të tyre në seline të shoqërisë të paktën 15 (pesëmbëdhjet) ditë para mbledhjes së Asamblesë e cila i miraton me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 50% (pesëdhjetpërqind) të pjesëve të kapitalit themeltar.
5. Miratimi i dokumentave që lidhen me ushtrimin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i ushtrimit financiar.

**Neni 21- Rezultati, caktimi dhe shpërndarja**

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes së amortizimeve dhe provizioneve.
2. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesëpërqind) që caktohet për rezervën ligjore deri sa të arrihet 10% (dhjetëpërqind) e kapitalit themeltar dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja dëshiron ti lërë mënjanë në formën e rezervave të zakonshme ose të jashtëzakonshme, u shpërndahen ortakëve në përpjestim me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruar respektivisht.



## **KAPITULLI I V** **SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 22- Prishja, Likujdimi**

1. Përrjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi e parashikuar nga ligji, Shoqëria mund të prishet në mbarim të afatit të caktuar në statut ose me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.
2. Përvec rastit të bashkimit ose të ndarjes prishja e shoqërisë për çfardo shkak qoftë sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryet nga një ose disa likujdatorë të emëruar nga Asambleja, të cilët kryejnë këtë detyrë në përputhje me ligjin nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
3. Likujdatori përfaqëson shoqërinë. Ai ka kompetenca të plota për të shitur aktivet e shoqërisë, për të shlyer kreditorët dhe për të shpërndarë mbetjen e disponueshme në përpjestim me pjesët e ortakëve në kapitalin themeltar.
4. Me përfundimin e procedurës së likujdimit të Shoqërisë, Asambleja do të vendosë, me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar, mbi bilancin financiar përfundimtar mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likujduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likujdimit.

### **Neni 23- Transformimi i Shoqërisë.**

1. Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite vetëm me miratim unanim të ortakëve, ndërsa mund të shndërrohet në Shoqëri Anonime me miratimin e shumicës së ortakëve që mbajnë më shumë se  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar.

### **Neni 24-Kundërshtimet**

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### **Neni 25- Shpenzimet.**

1. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u perkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.



**Neni 26- Të tjera**

1. Ky Statut është përgatitur në kater kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

**Parë dhe miratuar në Berat, më 29.05.2007.**

**ORTAKËT E "TOSKA" SH.P.K.**

**AFRIM DOSTI**

*Afrim Dosti*

*Afrim*

**BEHAR TOSKA**

*Behar Toska*

*Behar*